

UDHËZIM

Nr.6, datë 21.10.2010

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.10289, DATË 17.6.2010 "PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT EKONOMIK E FINANCIAR DHE PËR DHËNIE NDIHME TË MENJËHERSHME FAMILJEVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS, TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM, TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT, TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT DHE TË POLICISË SË BURGJEVE, QË HUMBIN JETËN NË KRYE APO PËR SHKAK TË DETYRËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010 "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës" dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", në vijim i referuar si ligji, konsiderohen "Humbje e jetës në krye apo për shkak të detyrës", rastet që ndodhin:

- gjatë kohës së kryerjes së detyrës apo shërbimit, kur ngjarja ka ndodhur për arsye që lidhen me detyrën;
- jashtë kohës së kryerjes së detyrës, kur shkak për ndodhjen e ngjarjes janë veprimet e ligjshme të punonjësit në kryerjen e detyrës.

Rrethanat e mësipërme duhet të vërtetohen nga organet e drejtësisë, prokurori, gjykata, sipas juridiksionit të tyre.

2. Përfitimet, që jepen sipas nenit 2 të ligjit, garantohen nga Buxheti i Shtetit. Llogaritja, caktimi dhe pagimi i përfitimeve bëhen nga strukturat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Në çdo rast, kur punonjësi humbet jetën në krye apo për shkak të detyrës, anëtarëve të familjes së caktuar në nenin 3 të ligjit, u jepet një ndihmë e menjëhershme financiare, jo më pak se 200 000 (dyqind mijë) lekë për çdo person, pasi nga subjektet përfituese të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Procesverbali i referimit nga strukturat përkatëse të rrjedhës së ngjarjes, gjatë së cilës humbi jetën punonjësi;
- vendimi apo vërtetimi, ku organi i drejtësisë të shprehet për shkakun e humbjes së jetës;
- certifikatë e gjendjes familjare në datën e ndodhjes së ngjarjes;
- certifikatë vdekjeje e punonjësit;
- dokumenti i identitetit të personit që kërkon përfitim.

Masa e ndihmës së menjëhershme financiare dhe subjektet që e përfitojnë atë, miratohen me urdhër të titullarit të institucionit qendror dhe përballohen nga buxheti i miratuar për njësinë shpenzuese përkatëse.

4. Në zbatim të nenit 4 të ligjit, organizimi i ceremonisë dhe shpenzimet e varrimit për punonjësit, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, miratohen nga titullari i institucionit qendror dhe përballohen nga buxheti i miratuar për njësinë shpenzuese përkatëse, sipas dokumenteve që justifikojnë shpenzimet.

816 4

5. Në zbatim të nenit 5 të ligjit, për çdo vit akademik strukturat e përmendura në nenin 1 të ligjit, i paraqesin Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, listën e fëmijëve që kanë fituar të drejtën e ndjekjes së studimeve të larta, për trajtimin e tyre me bursë.

6. Në zbatim të nenit 6 të ligjit, trajtimi me strehim i familjeve të punonjësve, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, bëhet sipas kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, duke realizuar trajtimin me përparësi të këtyre familjeve, krahasuar me subjektet e tjera përfituese sipas ligjit.

7. Në zbatim të nenit 7 të ligjit, masa e ndihmës me rastin e ditës përkujtimore të punonjësit, miratohet me urdhër të titullarit të institucionit qendror dhe përballohet nga buxheti i miratuar për njësinë shpenzuese përkatëse.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha